



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-16593/25  
Kaçanik: 29.07.2025

Në bazë të nenit 9 paragrafi 1.8 i Udhëzimit Administrativ nr.03/2012 - MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 korrik 2025,

### INFORMOHET

1. Me aktivitetin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2025, me tekstin e mëtejme, Raport 6 mujor i punës së KKSB- së për vitin 2025.
2. Në materialin e raportit të përcaktuar si në pikën 1 të kësaj shkrese, janë paraqitur të gjitha takimet të cilat i ka mbajtur KKSB gjatë periudhës: Janar-qershor 2025, ku është debatuar gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut si dhe rekomandimet të cilat i kanë nxjerrë ky këshill në takimet e mbajtura.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është, Raporti 6 mujor i punës së KKSB- së për vitin 2025 si në Lëndën: 01Nr.104/02-16593/25.

Me këtë shkrese njoftohen: Kryetari i Komunës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli





Republika e Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

Data	16.07.25	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	106/02-16093
		Shtojcë	✓

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)-

01.Nr. zyrtar/ 2025

## Raporti 6 mujor i punës së KKSB –së për vitin 2025

Takimi i parë i KKSB për vitin 2025 është mbajtur më 04.03.2025 të këtij viti të cilin e ka udhëhequr Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës:

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut në periudhën në mes dy takimeve

3.Analiza e rekomandimeve për vitin 2024-identifikimi i prioriteteve për vitin 2025

4.Të ndryshme

Për gjendjen e sigurisë në komunën tonë ka raportuar Komandanti i Stacionit të Policisë z. Halim Shehu i cili raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2024.Ai gjithashtu njoftoi edhe mbi planet operative që ka ky stacion policor e sidomos planin e menagjimit të situatës për muajin e ramazanit.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime :

- 1.Të respektohet ligji për komunikacion pavarësisht të ankesave që ju drejtohen Institucioneve .
- 2.Të identifikohen objektet e vjetra që mundë të paraqesin rrezik potencial dhe të mirren masa paraprake .
- 3.Një koordinim i veprimeve të institucioneve të nivelit qendrorë dhe lokal në trajtimin e qenëve endacak.
- 4..Të mirren masa paraprake për sigurimin e ujit të pijshëm sidomos gjat sezonit të verës .
- 5.Inspektorët Komunal të jenë më aktiv sidomos gjatë inspektimeve të marketeve të cilët kanë produkte me afat të skaduar .

6. Të ndjeken rrugët ligjore në mbrojtjen e pronës private .

7. Të respektohet ligji që ndalon ndotjen akustike .

8. Veprime konkrete në parandalimin e dukurive negative e sidomos nëpër shkolla .

9. Të punohet më shumë në zgjidhjen e qështjes së kamerave të sigurisë .

Takimi i dytë i KKSB është mbajtur më **20.05.2025** që është kryesuar nga Kryetari i Komunës dhe janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e qytetarëve . Për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i stacionit të Policisë në Kaçanik z. Emrush Lalinovci. Pasi që ishte në detyrën e re si komandant i Stacionit të Policisë në Kaçanik ai shprehu gadishmëri për bashkëpunim me të gjithë akterët e sigurisë për ruajtjen e sigurisë qytetare. Periudhën në mes dy takimeve e cilësoi si të qetë edhe pse në këtë periudhë kohore ndodhi vrasja e zyrtarit policorë ku më pas pasoi edhe arrestimi i disa të dyshuarve në lidhje me këtë vrasje. Sipas tij kjo situatë e krijuar ka ngritur shqetësim tek qytetarët por që situata është nën kontrollë

Pikat e rendit të ditës nga ky takim ishin:

**1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .**

**2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën mes dy takimeve .**

**3. Masat parandaluese kundër dhunës dhe bulizmit në shkolla**

**4. Ndërgjegjsimi për rreziqet në internet**

**5. Të ndryshme .**

Për shtjellimin e temës mbi masat parandaluese kundër dhunës dhe bulizmit në shkolla në takim me ftesë të Kryetarit dhe duke u bazuar edhe në Planin e Punës së KKSB ,prezent ishin edhe psikolog të cilët na njoftuan lidhur me aktivitetet që zhvillohen nëpër shkolla në parandalimin e dhunës dhe bulizmit.

Rekomandimet nga ky takim ishin:

1. Të shikohet mundësia që në ligjërata që mbahen në shkolla, të involvohen edhe përfaqësues nga BIK e që janë të licencuar .

2. Të krijohet një rrjet ndërinstitucional me një platëformë bashkëpunimi në ruajtjen e mirëqenjes psikologjike të fëmijëve .

3. Të bëhet plotësim ndryshimi i rregullores 2018 për shkolla ngase shumë gjëra kanë ndryshuar duke e përfshi edhe formën e shfaqjes së bulizmit.

4. Të zbatohet kodi etik i veshjes tek mësimdhënësit dhe nxënësit .
5. Të krijohen kushte më të mira për Psikolog .
6. Të krijohet një strategji e re për luftimin e bulizmit kibernetik .
7. Të shpejtohet veprimi i institucioneve qendrore në digjitalizimin e shkollave .

Mbledhja e tretë e KKSB duke ju referuar edhe Planit të Punës për vitin 2025 është mbajtur më datë 01.07.2025 i kryesuar nga Nënkryetari i Komunës , me këto pika të rendit të ditës:

#### **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

#### **2. Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**

#### **3. Roli i qytetarëve në parandalimin e vandalizmit**

#### **4. Përmisimi i sistemit të ndriqimit dhe infrastrukturës**

#### **5. Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese -Bashkëpunimi me OJQ**

#### **6. Të ndryshme**

Për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë z.Emrush Lalinovci.

Sipas Komandantit të Policisë në këtë periudhë si më shqetësuese ai theksoi dëmtimin e pyjeve për çka policia ka marrë edhe punë dytore në përmisimin e gjendjes.

Sipas pjesëmarrësve në parandalimin e vandalizmit rol të madh kanë edhe qytetarët duke i raportuar rastet, ngase kjo dukuri nënkupton shkatërrim të pronës publike dhe private e që ndikon negativisht në cilësinë e jetës së përditshme. Gjithashtu qytetarët duhet të kuptojnë pasojat ligjore, ekonomike dhe morale të vandalizmit. Rol kyq në parandalimin e kësaj dukurie kanë edhe prindërit dhe mësimdhënësit në edukimin e fëmijëve në ruajtjen e pronës publike.

Në diskutim për këtë temë në takim ishte edhe Drejtori I Shërbimeve Publike dhe Emergjencia I cili raportoi mbi krijimin e hapsirave publike që ka bërë komuna por që sipas tij edhe dukuria e vandalizmit ka qenë prezente .Sipas Drejtorit komuna ka investuar edhe në ndriqimin e hapsirave publike e gjithashtu një përkujdesje ju ka kushtuar edhe infrastrukturës në përgjithsi.

Rekomandimet e nxjerrura nga kjo mbledhje ishin:

- 1.Vetdijsimi i qytetarëve për raportim ndaj formave të vandalizmit
- 2.Të mirren masa ligjore ndaj atyre që dëmtojnë pronën publike e private
- 3.Angazhim i gjith akterëve në ruajtjen e pyjeve
- 4.Të gjindet një zgjidhje e shpejtë në instalimin e kamerave të sigurisë.
- 5.Një bashkëpunim edhe më i madh i institucioneve me OJQ në ngritjen e kapaciteteve të këtyrë organizatave

Krahas tri takimeve të rregullta me ftesë të Kryetarit të Komunës, KKSB më datë 23.04.2025 ka mbajtur një mbledhje urgjente që kishte të bëjë me situatën e krijuar në komunë pas vrasjes së zyrtarit policor dhe arrestimet që pasuan pas këtij rasti.

Në këtë takim pos anëtarëve të KKSB prezent ishin edhe përfajqsues nga Ministria e Punëve të Mbrenshme si dhe nga Inspektorati i Policisë së Kosovës.

Për gjendjen e krijuar raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë z.Halim Shehu ndërsa në diskutim u involvuan të gjithë akterët që ishin prezent në këtë takim.

Nga ky takim u apelua tek qytetarët që të ulin shqetësimet e tyre dhe mos të bien pre e disa informacioneve të rrejshme por të ju besojnë organeve kompetente të sigurisë dhe drejtësisë.

Gjithashtu ju bë apel qytetarëve për bashkëpunim në parandalimin e çdo dukurie që cenon sigurinë qytetare me shpresë që raste të tilla të mos përsëriten.

Nga ky takim u nzorën edhe disa rekomandime e që ishin:

- 1.Qytetarët të mos bien pre e informacioneve që dalin nga thashethëmet , debatet televizive , rrjetet sociale që japin informacione të pavërteta, por të ju besojnë komunikatave që dalin nga institucionet përkatëse shtetërore .
- 2.Të mirren veprime konkrete për parandalimin e çdo dukurie që cënon sigurinë qytetare .
- 3.Të krijohet fryma e bashkëpunimit në mes qytetarëve dhe Policisë në parandalim të dukurive negative
- 4.Mediat të mos japin lajme alarmante duke i dhënë qytetit tonë një epitetë që nuk e meriton .
- 5.Organet kompetente të e përcjellin aktivitetin e disa grupacioneve të cilët janë si të dyshuar .
6. Çdo neglizhencë e Policisë për shërbim ndaj qytetarëve të adresohet në formë ankese në Eëb faqen e IPK.

7. Të rregullohet sistemi i ndriqimit në disa pjesë të qytetit .

8. Të ndalohen disa projekte të OJQ - ve të cilat e keqpërdorin paranë publike .


Temat kryesore që janë diskutuar në takimet e KKSBB në mënyrë më detajuar janë në procesverbalet të publikuara në Web.faqën e Komunës në folderin e sigurisë.

Të gjitha këto tema janë paraparë edhe në planin e Punës së KKSBB-së për vitin 2025 por që janë diskutuar edhe për tema të aktualitetit që ndërlidhen me qështjen e sigurisë.

Monitorues në këto takime ishte përfajqsuesi OSBE-së .

Kaçanik , më \_\_\_\_\_

Kryetari i Komunës

 Besim Ilazi \_\_\_\_\_

